



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2018

**PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLIMEVE SPECIFIKE LIDHUR ME
STRUKTURËN DHE ORGANIKËN E QENDRËS SË PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 133, pika 4 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” me propozim të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.
2. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve krijohet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe financohet nga buxheti i shtetit, i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.
3. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka si mision kryesor realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit.
4. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ushtron këto funksione dhe përgjegjësi:
 - a) në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe/ose, me administratën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur;
 - i) ndihmon në përgatitjen e dokumentit për lirimin me kusht, vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së;

- ii) përgatit planin individual të rishoqërimit dhe rehabilitimit sipas programeve të shërbimeve;
- iii) përgatit planin e menaxhimit të riskut në rast të identifikimit të rrezikut të mesëm apo të lartë për recidivizëm;
- iv) ndjek dhe mbikëqyr ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore dhe situatën sociale të të miturit pas dënimit;
- v) administron në dosje të posaçme kopje të dokumentacionit individual të të miturit të lëshuara nga Shërbimi i Provës dhe administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturin.
- vi) administron Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim evidentimin e të dhënave që lidhen me datat e fillimit dhe mbarimit të dënimit.

b) në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës:

- i) miraton planin e rehabilitimit dhe rishoqërimit të të miturit;
- ii) koordinon masat që do të merren për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe të rishoqërimit;
- iii) mbikëqyr ecurinë e zbatimit të planit për rishoqërimit të të miturit;
- iv) organizon dhe zhvillon takime me të miturit, familjen dhe institucionet e tjera që mundësojnë përfshirjen sociale të të miturit;
- v) siguron përmbushjen dhe rishqyrtimin e programeve në mjediset e burgimit, nëse kjo është e nevojshme.

c) në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor:

- i) nxit marrjen e masave për strehimin e përshtatshëm për të miturin që nuk ka strehim;
- ii) siguron për të miturin:
 - a. veshje të përshtatshme;
 - b. mbështetje psikologjike;
 - c. shpenzimet e udhëtimit për në banesë;
 - ç. mundësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional, arsimit apo punësimit, pas lirimit;
 - d. kujdesin e nevojshëm nga autoritet shëndetësore përfshirë edhe në rastet e aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga, të sëmundjeve mendor, si dhe në raste të tjera;
- iii) mbikëqyr cilësinë e ofrimit të shërbimit ndaj të miturit.

ç) ndjek procesin e programimit dhe koordinimit të trajnimit dhe të specializimit të profesionistëve për drejtësinë për të miturit, si dhe i propozon institucioneve kompetente tema dhe metodika të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve.

5. Bazuar në përcaktimet e pikës 4 të këtij vendimi, Ministri i Drejtësisë i propozon Kryeministrit për miratim strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe

funksionimin e administratës shtetërore. Në përcaktimin e përshkrimeve të punës dhe kriterëve për rekrutimin e punonjësve të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Ministri i Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike marrin masa që të sigurojnë personel të kualifikuar për çështjet e drejtësisë për të mitur dhe kryesisht me formim arsimor punonjës social dhe psikolog.

6. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

7. Marrëdhëniet e punës së titullarit dhe të nëpunësve të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

8. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet *“Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”*, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”*, të ndryshuar.

9. Vula e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka formën dhe elementet e përcaktuara në Vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, *“Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”*. Vula, prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve miratohet nga Ministrit i Drejtësisë, me propozimin e titullarit të institucionit.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2019.

KRYEMINISTRI

Edi Rama